

SHKUPI


LAJMËTARI INFORMATIV I QYTETIT TË SHKUPIT

NUMËR PA
PAGESE

СКОПЈЕ

Numër 3 Viti II 25.02.2009

LLAMPA TË REJA KYRSYESE PËR RRUGËT E QYTETIT



NDRYSHIMI I LIGJIT PËR QYTETIN E SHKUPIT - PRIORITET

KOPSHTI ZOOLOGJIK I SHKUPIT NË FAMILJEN EVROPIANE TË
KOPSHTEVE ZOOLOGJIKE



"SHKUPI"

LAJMËTARI INFORMATIV I
QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ
"Shkupi" u botua më
10 dhjetor 2008

Del çdo të mërkurë të tretë të
muajit

Kryeredaktor
Ljupço Pandilovski

Zëvendës kryeredaktor
Nafie Selmani
Elena Kuzmanovska

Redaksia
Seksioni për marrëdhënie me
opinionin

Fotografia
Radomir Jovanović

Përkthyes dhe lektorë
Behar Dalipi
Merita Abdullai
Sadije Dalipi
Vladimir Bogdanovski

BOTON QYTETI I SHKUPIT
për botuesin
Kryetari i Qytetit Trifun Kostovski
Bulevardi Ilindenska p.n.

Telefon
02 3297 255
02 3297 265

e-mail adresa
mediumi@skopje.gov.mk
gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni: REPRINT



Të nderuar shkupjan,

Administrata e qytetit gjatë muajit janar përfundoi një pjesë të madhe të aktiviteteve përgatitore për vazhdimin e ritmit punues, për të cilin shpresoj se do të vazhdoj të pulsojë gjatë zhvillimit të Shkupit edhe në të ardhmen.

Qyteti i Shkupit kah fundi i muajit të kaluar shpalli tender për ndërtimin e depos së tramvajit, për gjatësinë prej 12 km të binarëve si dhe për furnizimin e pesë tramvajeve të reja. Thirrja është e shpallur edhe në gazetën e famshme të Bashkësisë Evropiane për furnizime publike dhe me këtë presim që një numër i madh i brendeve me renome botërore t'i dorëzojnë ofertat e tyre deri te qyteti. Do të thotë, startojmë me një projekt i cili i mungon qytetit të Shkupit që të zgjidhen problemet e shumta në fushën e transportit publik, me këtë do të përmirësohet edhe fotografia ekologjike e qytetit por edhe në kushte të krizës së madhe botërore, të fillojmë një investim kapital i cili pozitivisht do të ndikoj në ekonominë vendase.

Qyteti i Shkupit, mendoi në mënyrë pragmatike në drejtimin zhvillimor edhe gjatë përpilimit të programeve zhvillimore në suaza të Buxhetit për vitin 2009. Ne parashikuam zëra të cilat gjatë viteve të ardhme, nëse respektohen, në masë të konsiderueshme do ta ndryshojnë pamjen e metropolit. Do të fillojmë qysh nesër. Zgjerimi i bulevardit Vidoe Smilenski – Bato është filluar dhe me atë do të zgjerohet aksi rrugor i cili u shkaktonte probleme dhe kokë dhembje të mëdha vozitësve dhe këmbësorëve. Po bëhen përgatitjet e fundit për zgjerimin e aksit rrugor afër Kombinatit të duhanit dhe për zgjerimin e rrugës me katër shirit deri te bulevardi 3 në "Makedonska Brigada". Gjithçka është gati edhe për fillimin e fazës së 3-të në bulevardin "Serbia" të cilin gjatë vitit të kaluar e bashkuam në USJE.

Të nderuar,

Edhe këtë vit ne vazhdojmë me ndryshimin e llambave rrugore. Vitin e kaluar kemi zëvendësuar 2350 llamba, këto ditë duhet të filloj vendosja e 3100 llambave të reja ekonomike të cilat janë më efikase në aspektin energjetik. Mendoj se e ndaj mendimin Tuaj për përmirësim drastik të ndriçimit urban, që prej mesit të këtij viti do të bëhet pothuajse njësoj sikur edhe në metropolet botërore, kurse kursimet, Qyteti i Shkupit në të ardhmen do të mund t'i ri investoj dhe me këtë për një periudhë të shkurtër kohore të shërbej si një shembull pozitiv për të gjitha metropolet Ballkanike për sa i përket ndriçimit publik.

Ndriçimi publik përcillet me rregullimin e gjelbërimit të bukur qendrorë nëpër bulevardet. Vazhdojmë edhe më tej me ngritjen e zhardinerive betonike përgjatë Entit të mëparshëm për qarkullimin pagesor drejt bulevardit Jane Sandanski, po ndërtohet zhardineria në hyrje të qytetit të Shkupit në Autokomandë, kurse në fazë përfundimtare janë edhe tenderët për zhardineritë në bulevardin "Partizanski odredi". Zhardineritë e ndërtuara dhe ato që janë në fazë të ndërtimit do të rregullohen në aspektin hortikulturorë prej ekipeve të NP "Parqet dhe gjelbërimit", besoj se nëpër bulevardet e Shkupit do të kemi një pranverë të mrekullueshme.

Kur i përmend ndërmarrjet publike, dua të potencoj se edhe këtë vit Qyteti në interes të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët do të subvencionoj më shumë se 4 milionë euro prej buxhetit të tij. Kjo filozofi për ndihmë financiare është e imponuar prej nevojës që të konsolidohet sistemi i cili e paraqet imazhin e Qytetit të Shkupit.

Buxheti i Qytetit këtë vit do të ndaj 90 milion denarë për përkrahje të institucioneve kulturore, programeve të tyre si dhe për programet e organizatave joqeveritare dhe të individëve nga fusha e kulturës. Qyteti ka pamjen që duhet të jetë e liruar prej brengave të përditshme dhe t'i ofroj qytetarëve të saj një përbajtje të pasur kulturore me çka do ta afirmojmë pasurinë tonë kulturore, artistët e talentuar dhe njëkohësisht do të bëjmë edhe promovimin tonë turistik në suaza ndërkombëtare.

Faktet për të cilat po Ju flas, paraqesin vetëm një segment i cili mund të zbatohet. Menaxhimi cilësor i mjeteve Tuaja është pjesë e reformave pozitive të ligjeve për pozitën sistematike të Qytetit dhe për financim stabil të kompetencave.

Kjo në veçanti do të vij në shprehje në fazën përfundimtare të qasjes në integrimet evrop-atlantike, për arsye se edhe decentralizimi paraqet reformë me karakter esencial.

I juaji,
Trifun Kostovski

Qyteti i Shkupit edhe sivjet kyçet në fushatën për kursimin e rymës

3.100 LLAMPA TË REJA KYRSYSE NË RRUGËT E QYTETIT

Ndriçimi i ri në qytet do ta përmirësojë shikueshmërinë dhe sigurinë në trafik dhe në mënyrë të dukshme do ta zvogëlojë llogarinë e energjisë elektrike

Elena Kuzmanovska

Tre mijë e njëqind llamba të reja ndriçuese prej kësaj vere do t'i ndriçojnë rrugët magjistrale dhe mbledhëse të qytetit. Aksionin për zëvendësimin e ndriçimit të vjetër Qyteti i Shkupit e filloi vitin e kaluar kur u zëvendësuan 3.100 llampa. Deri në mesin e muajit prill pritet që të nënshkruhen marrëveshjet për furnizimin dhe montimin e llampave kurse deri në fund të muajit qershor në rrugët e qytetit të vendosen të gjitha llambat e planifikuara.

- Llambat e reja janë kursyese, ato do të mundësojnë kursimin e energjisë elektrike prej minimum 30%. Me këtë do të zvogëlohet llogaria për rymë që e paguan Qyteti për ndriçimin e rrugëve. Llamba ka afat përdorimi dhjetë vjeçar, ndërsa vet poçi - tre. Me këtë, harxhimet për mirëmbajtjen sillet në minimum. Qyteti i Shkupit në mënyrë aktive u kyç në fushatën për efikasitet energjetik dhe harxhim më të vogël të rymës. Qyteti veç më i ka ndjerë efektet nga kursimi i cili u arrit me vendosjen e 2.350 llambave kursyese në aksionin e vitit të kaluar. Deri tani te ato nuk është regjistruar asnjë defekt - thonë nga Sektori për veprimari komunale të Qytetit të Shkupit.

Qyteti i Shkupit me ndryshimin e bërë të llambave ndriçuese në pjesën e rrugëve magjistrale dhe mbledhëse në qytet dukshëm e zvogëloi harxhueshmërinë e energjisë elektrike për ndriçim publik edhe atë rreth 1,5 GW në nivel vjetor. Sipas çmimit aktual të energjisë elektrike, kursimi në llogaritë është rreth 6.400.000 denarë ose rreth 105.000 euro në nivel vjetor. Kjo do të thotë se vetëm mbi bazë të kursimit të energjisë elektrike, investimi për ndryshimin e llampave kthehet për periudhë prej katër vjet. Duke marrë parasysh se kursimi kryhet edhe për

shkak të afatit garancues të llambave të reja, përkatësisht për shkak të mos pasjes nevojë për servisim të ndriçimit publik të rrugëve ku janë vendosur llambat e reja, periudha për kthimin e investimit zvogëlohet dhe sillet rreth tre vjet.

Aksioni i vitit të kaluar për ndryshimin e llambave të rrugës zhvilloheshte prej 25 korikut deri më 25 gusht. Gjatë kësaj, u demantuan llambat e reja, u zëvendësuan kabllo të shtylla, u montuan llambat e reja dhe u krye kontroll mbi punën e tyre.

Llambat, pas procedurës së kryer për furnizim publik ku morrën pjesë katër ofertes, u furnizuan nga kompania Mienel-Schreder e Austrisë dhe për to Qyteti i Shkupit ndau 370.631 euro. Demontimi i llambave të vjetra dhe montimi i të reja me zëvendësimin e kabllove, gjithashtu pas realizimit të furnizimit publik në të cilën morrën pjesë katër ofertues, u krye nga ana e firmës "Elektroizgradba" e Shkupit dhe kushtoi 4.808.500 denarë.

Vlera e përgjithshme për furnizimin, demontimin dhe montimin e llambave është rreth 27.676.500 denarë ose rreth 450.000 euro.

Gjatë ndryshimit, poçet e vjetra me fuqi prej 400W u zëvendësuan me të reja me fuqi prej 250W dhe 150W ku është fituar efekt i ndriçimit më të madh të rrugëve dhe me këtë është ritur siguria e pjesëmarrësve në trafik. Zëvendësimi i llambave u krye në periudhën e pushimeve vjetore dhe pushimit veror të nxënësve dhe studentëve, kur frekueca e automobilëve në rrugë është më e ulët, dhe kjo nuk shkaktoi pengesa në trafik, punë pa nevojë të automobilëve dhe me këtë nuk u shaktua edhe ndotja e panevojshme e ajrit në qytetin e Shkupit.

Do të përgatitet studim për ndriçimin publik

Në Qytetin e Shkupit është në procedurë përgatitja e dokumentimit tenderik për shpalljen e furnizimit publik për përgatitjen e studimit për menaxhimin e ndriçimit publik të qytetit. Studimi duhet të propozojë mënyrë se si më së thjeshti të kyçet ndriçimi publik në moment të njëjtë dhe të mënjanohet mundësia përndriçim ditën. Qyteti i Shkupit pret që të ofrohen më shumë mundësi për zgjidhjen e këtij problemi, nga të cilat më pas Qyteti i Shkupit do ta zgjedhë mënyrën më të volitshme.

NDRYSHIMET E LIGJIOT PËR QYTETIN E SHKUPIT – ÇËSHTJE POLITIKE PRIORITARE

Përvoja katërvjeçare pas fillimit të procesit të decentralizimit, identifikoi një sërë dobësi në pozicionimin sistematik si dhe në organizimin territorial të Qytetit të Shkupit.

Tome Smilevski

Pozicionimi i tanishëm sistematik i Qytetit në masë të konsiderueshme e pamundëson zhvillimin e tij dhe paraqet pengesë në synimet e tij që të bëhet një metropol Evropian dhe botërorë. Për momentin, qyteti i Shkupit paraqet një konglomerat i pa definuar, i copëtuar në mes fujisë dhe kompetencave të pushtetit qendror dhe komunave. Në kushte të tilla, Qyteti ka pronësi të pa definuar, kompetenca gjysmë

të definuar dhe kontroll simbolik të proceseve ekonomike, kulturore dhe zhvillimit shoqëror. Për këto arsye, Kryetari Kostovski ngriti iniciativë për ndryshimin e Ligjit për Qytetin e Shkupit.

- Mund të numëroj mijëra arsye përse qytetit të Shkupit i përgjigjet organizimi i tillë territorial, por asnjëra prej tyre nuk qëndron arsyetimit që ka karakter politik – deklaroi Kostovski në një tribunë në suaza të iniciativës për ndryshim të Ligjit për Qytetin e Shkupit.

Sot, çështja për ndryshimin e Ligjit për Qytetin e Shkupit imponohet si një çështje politike prioritare.

- Tema ka një rëndësi prioritare politike. Me një transparencë dhe sinqerisht theksoj se në mungesë të

një ligji të tillë është relative rëndësia për zgjedhjen e Kryetarit të Qytetit të Shkupit – theksoi Kostovski.

Në suaza të kësaj iniciative u mbajtën më shumë tribuna, në të cilat një numër i madh i ekspertëve nga fusha e vetëqeverisjes lokale, sistemit politik, arkitekturës, urbanizmit, sociologjisë si dhe gazetarë dhe përfaqësues të sektorit joqeveritar, gjithashtu e përdëftuan nevojën për ndryshimin e ligjeve ekzistuese për kryeqytetin, të cilat nuk e operacionalizojnë veçorinë e tij kushtetuese. Iniciativa e z. Kostovskit rezultoi me propozimin ligjin për Qytetin e Shkupit në të cilin janë të theksuara udhëzimet për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese për Qytetin e Shkupit.



Duke u nisur prej dobësive dhe të pathënave në ligjet ekzistuese, në procesin e krijimit të Propozim-ligjit për ndryshimet u inkuadruan ekspertë më eminent si dhe opinioni më i gjerë. Propozim-ligji u dorëzua deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë qysh në muajin tetor të vitit të kaluar.

Sipas ndryshimeve të propozuara, qyteti i Shkupit duhet të rregullohet si një komunë me më shumë kuarde (distrikte) që do të ishin nën kompetenca të tij. Me këtë do të shmangeshin ndarjet e kompetencave dhe bllokimi mes komunave dhe do të sigurohet kryerja më ekonomike e disa kompetencave të caktuara. Me organizimin e ri territorial të Qytetit duhet të përcaktohen kufijtë e ri të tij, për arsye se me zgjidhjet ligjore aktuale Qyteti nuk ka territor të tij (Qyteti shtrihet në territorin e komunave). Komunat rurale duhet të ndahen prej bërthamës urbane,

gjatë kësaj dygjuhësia nuk do të rrezikohet. Shkupi në nivelin e sotëm të decentralizimit dhe me mjetet financiare ekzistuese, nuk është në gjendje ta financoj zhvillimin ekonomik lokal, kushtimisht thënë për komunat e pazhvilluara, siç janë Saraji, Gjorçe Petrovi, Buteli dhe Shuto Orizare. Nga ana tjetër, të hyrat e këtyre komunave do të ishin tejet të larta dhe më shpejtë do të zhvilloheshin nëse gjenden jashtë kufijve të Qytetit të Shkupit.

Me ligjin e ri për Qytetin e Shkupit duhet të determinohen të hyrat e tij, duke pasur parasysh faktin se Qyteti i Shkupit vetëm me një përqindje të vogël të mjeteve financiare nga buxheti shtetërorë, nuk mund t'i realizoj projektet kapitale infrastrukturore që janë në interes të qytetarëve. Gjithashtu, sipas lartësisë së buxheteve, Qyteti i Shkupit as përafërsisht nuk mund të krahasohet me kryeqytetet tjera të rajonit dhe

të metropoleve Evropiane. Është i domosdoshëm zmadhimi i buxhetit përmes zmadhimit të ardhurave nga tatimi personal dhe prej TVSH-së dhe udhëheqjes së tokës ndërtimore. Ndryshimet në politikat fiskale duhet ta zmadhojnë fuqinë financiare të qytetit, duke pasur parasysh faktin se qyteti nuk paraqet vetëm një njësi të vetëqeverisjes lokale por se kryen edhe funksione që janë në interes të shtetit. Për këto arsye si dhe sipas numrit të banorëve të qytetit, Buxheti i Qytetit të Shkupit duhet të përfshij 1/3 e buxhetit shtetërorë.

Mbeten shpresat se Kryetari i ardhshëm i Qytetit të Shkupit, pavarësisht nga përkatësia e tij partiake do ta pranojë këtë projekt të finalizuar si parësorë, nëse me të vërtetë do të jetë i interesuar për funksionim normal të Qytetit dhe realizimin real të funksionit Kryetar i Qytetit të Shkupit.

Deklaruan:

Profesori në Fakultetin juridik, Gordana Siljanovska konsideron se sipas pozitës së tanishme sistematike, qyteti i Shkupit në vend të metropolit mund të shëndërohet në një nekropol.

- "Nuk ekziston ndonjë kryeqytet në të cilin komunat në territorin e Qytetit i kanë kompetencat e njëjta sikur Qyteti. Ky është një fenomen i panjohur në vetëqeverisjen komparative lokale" Siljanovska thekson disa variante të reformave, prej të cilave varianti më i preferuar do të ishte ndarja e qytetit në distrikte me kompetenca të kufizuara krahas Qytetit.

Profesori Miroslav Gërçev, vlerësoi se vetëqeverisja lokale nuk mund të funksionoj me ligjet ekzistuese, për arsye se vetëqeverisja lokale nuk

posedon as pronë e as kompetenca të vërteta.

- "Vetëqeverisja lokale është një invalid, i varur prej vullnetit politik të pushtetit qendror. Qyteti duhet ta posedoj dhe të udhëheq infrastrukturën urbane".

Profesori Tanja Karakamisheva, theksoi se qyteti i Shkupit meriton një vend dhe një status të posaçëm.

- "Në vend të dimensionit të tanishëm "virtual" të kryeqytetit, Qyteti i Shkupit me një ligj të ri duhet të fitoj statusin e vërtetë të kryeqytetit".

Profesori Jove Kekenovski në tribunën në Fakultetin juridik theksoi se Shkupi nuk e meriton statusin momental, për arsye se specifikat kushtetuese nuk janë të operacionalizuara.



SHKUPI DHE MARRËDHËNIET NDËRETNIKE

Kur njeriu do të vendos të shkruaj për marrëdhëniet ndëretnike dhe mjedisin multietnik, sado që të tingëllojë stereotipe, nuk mund të thuhet se këto çështje janë të apsolvuara deri në fund dhe se ekzistojnë edhe çështje më të rëndësishme që e bëjnë përditshmërinë. Kësaj radhe qasja për këto çështje me shembull ndërlidhet me traditën e marrëdhënieve ndëretnike dhe me mënyrën e të jetuarit në kryeqytetin tonë, Shkupin. Mendoj se kryeqyteti ynë na mundëson mendim të kualifikuar, duke depërtuar në botëkuptimet tradicionale dhe bashkëkohore si dhe respektimin e ndërsjellët të jetës multietnike si dhe respektimin e ndërsjellët të njerëzve që flasin gjuhë të ndryshme, kurse zakonet, përkatësia kombëtare dhe fetare dimensionohen në një pasuri të diverzitetit kulturorë.

Në Qytetin e Shkupit, parë nga këndi historik, modernia është shtresuar në tejdukshmëri mbi tradicionalen, duke mbajtur llogari që të ruhet dhe sendërtohet ajo që njerëzit i bënë të jenë më tolerant, më solidar, më human dhe me respekt të ndërsjellët në një mjedis multietnik.

Faktografia historike dhe trashëgimia kulturore e kryeqytetit tonë, të pasqyruar dhe të ruajtur përgjatë shekujve përmes via-dukutit, urave, kishave, xhamive, sinagogave dhe shumë artefakteve të tjera, na flasin dhe përkujtojnë se Shkupi çdo herë u ka takuar të gjithë qytetarëve të saj, pa dallim të përkatësisë së tyre fetare dhe etnike. Atëherë logjikisht mund të konkludohet se e tashmja dhe e ardhmja e kryeqytetit tonë duhet të fisnikërohet me trende moderne të komunikimit dhe të ndërtimit të raporteve ndëretnike. Por, sado që kjo të tingëllojë "demode", mënyra e të jetuarit në bazë të fqinjësisë tradicionale dhe esnafllëkut të çarshisë, është një praktikë e verifikuar dhe e

përdëftuar e respektimit të ndërsjellët të dallimeve në mes njerëzve që duhet të kultivohet.

Në kohët e sotme, Shkupi tanimë është një metropol kulturorë, politik dhe diplomatik, ku civilizimet Evropiane, Ballkanike dhe Orientale, ndërlidhen me shumë elemente të ofruara prej bote të globalizuar.

Në një thurje të tillë të ngjarjeve dhe sfidave, si qytetarë të Shkupit, në asnjë rast nuk guxojmë ta humbasim kuptimin dhe bukurinë e jetës së përbashkët në qytetin multietnik.

Nëse bëjnë një analizë kronologjike nga distanca kohore, në kohën kur marrëdhëniet ndëretnike në Shkup kanë qenë më të mira ose më pak të mira, kjo nuk është varur njëqind përqind vetëm prej qytetarëve të zakonshëm. Këto raporte shpeshherë, qoftë të kenë qenë të mira ose më pak të mira, janë varur prej strukturave udhëheqëse, përkatësisht prej njeriut të parë të qytetit. Ka pasur edhe periudha të këqija të sundimit të qytetit, por falë Zotit, urtësia dhe tradita e qytetarëve çdoherë i ka refuzuar anash të tillët, si elemente destruktiv dhe të padëshirueshëm. Por, duhet të jemi të vetëdijshëm, saktë në mjedise multietnike siç është edhe qyteti i Shkupit, çdoherë gjinden edhe njerëz të tillë që përpiqen dhe për fat të keq ndonjëherë edhe ia dalin në çaste të caktuara t'i cenojnë marrëdhëniet ndëretnike. Për këtë arsye, në vazhdimësi duhet të punohet përmes institucioneve dhe organizatave joqeveritare të afirmohen dallimet kulturore si thesar i kryeqytetit tonë.

Shembujt që shkojnë në favor të marrëdhënieve të mira ndëretnike kohë pas kohe duhet të merren prej njerëzve të urtë gjatë historisë, si ata i kanë përshkruar këto marrëdhënie për qytetin e Shkupit. Të përkujtohem atë që ka thënë Pitagora për qytetarët

e Shkupit: "Mos u bëj i paturpshëm ndaj askujt". Kjo edhe ditëve të sotme është motoja e të jetuarit në qytetin tonë.

Fryma pozitive e qypit të vjetër, të predikuar nga Dervishi i Anadolisë në kohën e osmanlinjve, mbrojtësit të Çarshisë së vjetër, Shkupit ia dha sharmin e pakrahasueshëm të një metropoli të vërtetë kozmopolit. Banorët e tij i luten Zotit në kishat ortodokse, në xhamitë myslimane, katedralet katolike, sinagogat hebreje dhe në teqetë dervisha.

Një traditë e tillë është kompliment për qytetarët e Shkupit në ndërtimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërfetare, akoma më tepër na obligon që përkatësit e bashkësive etnike në mënyrë adekuate të përfshihen në organet dhe institucionet e qytetit. Në të kaluarën e afërme apo të largët, qëllimisht ose pa qëllim, është lëshuar ajo mundësi me pretext se mungojnë kuadrot me arsimim cilësor. Sot, situata është dukshëm e ndryshuar në të mirë kurse përfaqësimi i drejtë dhe adekuate është e rregulluar me Kushtetutë dhe me ligj dhe kjo duhet të respektohet. Nëse bëhet diçka më tepër në drejtim të përfaqësimit të drejtë të bashkësive etnike, e cila për fat të keq është vetëm simbolike, atëherë përgjegjësia është e personave që janë më të thirrur, përkatësisht udhëheqësisë së Qytetit. Kësaj sfide duhet t'i jepet përgjigje dinamike e cila me efikasitet dhe me shpejtësi do ta përmirësojë përfaqësimin e bashkësive etnike në administratën e qytetit.

Nuk guxojmë të japim shkas, por shkaset ekzistojnë, që gjatë kalimit të urave të lumit Vardar, përshtypja e parë dhe pamja e parë të jetë pjesa e majtë e parregulluar e kejit të Lumit Vardar. Për këtë arsye, ajo që është e projektuar prej pushtetit momental të qytetit e që ka të bëjë me anën e majtë të lumit Vardar, të realizohet urgjentisht, që të mbisundojë ndjenja se jetojmë bashkërisht dhe jo në një qytet të ndarë. Nëse pajtohemi, dhe këtu nuk duhet të ekzistojnë dilema, se kryeqyteti ynë qysh prej kohës së Justinianit të I -rë e deri në mandatin e z. Trifun Kostovski si Kryetarë i Qytetit të Shkupit, i ka takuar të gjithë qytetarëve, në mënyrë të barabartë, atëherë sfidave që do të vijjnë do tu përgjigjemi edhe me argumentet nga e kaluara.

Ismet Ramadani

(Këshilltar i Kryetarit të Qytetit të Shkupit për marrëdhënie ndëretnike)



INTERVJU E KRYETARIT KOSTOVSKI PËR JAVOREN E SELANIKUT "KENTRI"



Përcjellë
„Kentri“, Greqi
17.01.2009
Autori: Despina Kritiku

Për çfarë shkaqe kërkuat që të vendoset përmendorja e Aleksandrit të Madh në sheshin qendror të Shkupit?

-Shkaku kryesorë për këtë është ajo që nuk jam peng i kurtheve historike, që janë pretekst i armiqësive historike në Ballkan. Politikat të cilat aeroportin në Selanik e emëruan “Maqedonia”, kurse atë të Shkupit e emëruan “Aleksandri i Madh”. Politikat për shkak të së cilave Greqia e pengon evro-integritet tona në mënyrën më evropiane dhe u jep shansin platformave nacionaliste këtu tek ne. Vërtetë duhet t'i japim fund anakronizmave! Në Ballkan sot të gjithë ne duhet të “rritemi”!

Cili është propozimi juaj?

Propozimi im është që të ngritët një përmendore për yllin e madh dhe humanistin maqedonas i cili tragjikisht ndërroi jetën, këngëtari Toshe Proevski.

Si duket qeveria e IRJ të Maqedonisë shpenzon të holla për propagandë nacionale dhe me këtë e dezorienton popullin nga problemet serioze sociale (shëndetësinë, arsimin...).

Nuk besoj në asnjëfarë propagande afatgjate popullore. Për fat të keq, në afate të shkurta kjo shkakton dëme. Problemet sociale, gjë që e përdëftuan edhe protestat njëmu-jore në Greqi, janë çështjet më të rëndësishme për qytetarët e të dy vendeve tona.

Çka mendoni për të ardhmen e marrëdhënieve midis dy vendeve tona dhe çka prisni nga zgjedhjet e marsit?

Unë sinqerisht mendoj për të ardhmen e marrëdhënieve të mira në mes dy shteteve, marrëdhënie të cilat kanë shumë më tepër tipare dhe tradita të përbashkëta se sa dallime. Jam i bindur se në momentin kur ta tejkalojmë “kompleksin ballkanik”, dyja palët, përfitime do të kenë të dy popujt. Pres që Maqedonia në mars të ketë votime të qeta dhe të suksesshme.

Buxhetet e metropoleve në Evropën juglindore

ZAGREBI, SIVJETË DO TË HARXHOJË 1 MILIARDË E 100 MILIONË EURO

Buxhetet e metropoleve në Evropën Juglindore dhe në rajonin për vitin 2009 edhe njëherë dëshmojnë se Qyteti i Shkupit në planin financiar ka ngecje në masë të madhe. Të sjella në kushte të krizës ekonomike financiare dhe të vlerësuar si restriktive nga pushteti i atjeshëm i qytetit, për shembull buxhetet e Beogradit dhe të Zagrebit, janë për disa herë më të mëdha se Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2009. Duke i pasur parasysh këto fakte, Kryetari i Qytetit të Shkupit, Trifun Kostovski vazhdimisht potencon se qyteti i Shkupit nuk mund të zhvillohet si metropol vetëm me 1 përqind të mjeteve financiare nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Në mes tjerash, Kryetari i Qytetit Kostovski në iniciativën e tij për ndryshim e Ligjit për Qytetin e Shkupit bën përpjekje që edhe të ardhurat e Qytetit të Shkupit të determinohen me ligj të veçantë dhe të përbëjnë një të tretën e buxhetit të përgjithshëm të shtetit.

Buxheti i Qytetit Zagreb për vitin 2009 do të arrijë rreth një miliardë e njëqind milionë euro. Rritja e Buxhetit në raport me vitin e kaluar arrin 4.99 përqindë. Kryetari i Qytetit Zagreb, Millan Bandiq potencoi se pensionistët dhe qytetarët me gjendje më të dobët pronësie dhe të tjerët nuk do të mbesin pa të drejtat e deritanishme sociale, përderisa gjithçka tjetër, po gjithashtu edhe vonimi i pagave, do të jetë e hapur, gjë që kërkon kontratë me të gjithë partnerët social në muajt e ardhshëm. Bandiq vlerësoi se cikli investues do të mbahet në nivelin e tanishëm, kurse potenciale plotësuese Qyteti do të kërkojë ne riorganizimin e administratës së Qytetit.

Qyteti i Zagrebit planifikon për vitin 2009, deri te burimet e veta të realizojë diku rreth një miliardë dhe gjashtëdhjetë milionë euro, kurse rreth 40 milionë euro nga detyrimet, për shpenzime kapitale. Prioritete në infrastrukturën e trafikut-komunikacionit për vitin 2009 do të jenë zgjerimi dhe vazhdimi i disa bulevardëve dhe rrugëve, kurse parashikohet edhe lidhja e kontratës për projektimin e dy urave, si dhe fillimi i zgjedhjes së raporteve juridiko-pronësore të lidhura me realizimin e urave “Jarun” dhe “Bundek”. Orientimi qendror kapital i Qytetit do të jetë “modeli i Zagrebit për akomodim bane-sor” kurse aksenti do të jetë edhe në zhvillimin e vetëqeverisjes lokale.

T.S.

KOMPETENCA

KUSH PËR ÇFARË ËSHTË PËRGJEGJËS
NË VEPRIMTARITË KOMUNALE (PJESA 2)

KOMUNA

Qytetarët e Shkupit shpesh kanë problem me përkufizimin e kompetencave të Qytetit dhe të komunave, kështu që nuk mund t'i detektojnë saktë organet të cilat duhet t'ua zgjidhin problemet. Redaksia "Shkupi" me qëllim që t'u ndihmojë qytetarëve, në botimet që vijojnë do t'i publikojë kompetencat dhe ingjerenat e Qytetit të Shkupit.

- ndërtimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i parkingjeve publike me rëndësi për komunën të konstatuara me planin urbanistik

- organizimi, largimi dhe transportimi i mbeturinave komunale dhe mbeturinave të tjera të parrezikshme.

Komunat në Qytetin e Shkupit, për realizimin e punëve publike me rëndësi lokale në kornizat e ingjerenave të veta, mund të themelojnë shërbime publike, në pajtim me ligjin.

Të ardhurat nga kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore përcaktohen në raport 60% për Qytetin e Shkupit dhe 40% për komunën në Qytetin e Shkupit në të cilën rregullohet toka ndërtimore. Qyteti i Shkupit me mjetet që i pranon në bazë të kompensimeve për rregullimin e tokave ndërtimore është i detyruar ta ndërtojë infrastrukturën primare (rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, elektrik dhe të ngrohjes), përderisa komunat kanë obligim ta ndërtojnë infrastrukturën sekondare.

QYTETI I SHKUPIT

Furnizimi me ujë të pijshëm nga sistemi i vetëm për furnizim me ujë në qytetin e Shkupit;

- mënjanimin dhe pastrimin e ujërave të ndotur;

- mënjanimin dhe lëshimin e ujërave atmosferik;

- përpunimi dhe dërgimi i ujit teknologjik;

- mbledhja dhe transportimi hedhurinave komunale dhe hedhurinave të tjera të parrezikshme;

- mirëmbajtja e depove dhe llojit të tjetër të materialit komunal dhe hedhurinave tjera të parrezikshme;

- rregullimi dhe organizimi i transportit urban dhe ndërrurban të udhëtarëve.

- mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i parqeve të qytetit, park-pyjeve në territorin e qytetit të Shkupit, zonave ujore dhe sportive-rekreative, të konstatuara me Planin gjeneral urbanistik dhe territore të tjera të mbrojtura në harmoni me ligjin.

- ndërtimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i parkingjeve publike nga rëndësia për Qytetin e Shkupit, të konstatuara me planin urbanistik.

Qyteti i Shkupit, për realizimin e punëve publike me rëndësi lokale në kornizat e përgjegjësi të veta, mund të themelojë shërbime publike, në pëlqim me ligjin. Qyteti i Shkupit për atë qëllim i ka formuar ndërmarrjet publike "Higjiena komunale", "Ujësjellësi dhe kanalizimi", "Parqet dhe gjelbërimet", "Rrugët dhe rrugicat", "Parkingjet e qytetit" dhe Ndërmarrja e qarkullimit publik "Shkupi".

RINOVHET PAVIONI I QRS "SARAJ"

Pavioni-Rustik i qendrës rekreative sportive "Saraj" së shpejti do të rinovohet, kurse do të rregullohet edhe gjelbërimi përreth, informojnë nga NP "Parqe dhe gjelbërim". Pavioni është pesëmbëdhjetë vjet i vjetër dhe për shkak të dëmtimeve, për arsye sigurie, nuk mund të shfrytëzohet më për pushim dhe rekreim. Ekipet e "Gjelbërimi jashtë qytetit" në ndërmarrjen publike këto ditë po përgatisin materialin e duhur prej druri për rinovimin e objektit.

Në periudhën e ardhshme ekipet e "Parqe dhe gjelbërim" do të kryejnë edhe prerjen e pishave në sipërfaqe prej 12 hektarësh në vendin e quajtur Guri i bardhë në Vodno. Nga Vodnoja e mesme deri te pushimorja për fëmijë, përsëri, do të vendosen rreth 30 shporta-rustik për mbeturina, të cilat do të vendosen në vendet me frekuencë më të madhe. Me këtë aksion Qyteti i Shkupit kontribuon në mënyrë aktive për pastërtinë e ambientit.

A.XH.

TABELAT E REJA
"SINJALIZUESE"
VIKTIMË E
VANDALIZMIT

Tabela e reja "Sinjalizimi" të cilat Qyteti i Shkupit i vendosi në më shumë lokacione pothuajse para një muaji këto ditë përsëri ishin viktimë e vandalizmit. Janë dëmtuar dy tabela sinjalizuese, tek kisha "Shën. Spas" dhe në parkun e qytetit në bregun e lumit Vardar, ku tek njëra është shkatëruar një pjesë e tabelës, ndërsa tek tjetra pjesa rrethore e tabelës është hequr nga bazamenti metalik.

Qyteti i Shkupit muajin e kaluar i rinovoi tabelat, të cilat më parë ishin shkatërruar plotësisht nga qytetarë të pandërgjegjshëm dhe përsëri i ktheu në vendet e mëparshme për të treguar monumentet kulturore dhe trashëgiminë e pasur kulturore të qytetit.

Qyteti i Shkupit apelon deri te qytetarët të mos i shkatërrojnë tabelat sinjalizuese dhe të tregojnë përgjegjësi më të madhe ndaj trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe ndërtimore me të cilën duhet të krenohemi para mysafirëve të huaj, kurse ne vetë të mësojmë më shumë për ne dhe për qytetin tonë nga informatat që gjenden në tabelat sinjalitike.

ZGJEROHET BULEVARDI VIDEO SMILEVSKI BATO

Qyteti i Shkupit filloi realizimin e projektit për zgjerimin e bulevardit Vidoe Smilevski Bato në gjatësi prej 510 metër prej udhëkryqit me bulevardin Srbija deri te udhëkryqi me bulevardin "Fevruarski pohod".

Me zgjerimin në anën e djathtë do të fitohet bulevard me profil prej 23,5 metër gjërësi përgjatë tërë trasës. Korsitë e rrugës do të jenë të gjëra 10,5 metër, brezi i gjelbër 6,5 metër, ndërsa korsitë biçiklistike 2,5 metër. Trotoaret do të jenë të gjëra 4 metër.

Përveç zgjerimit të rrugës, në fazën e parë të zgjerimit të Vidoe Smilevski Bato do të ndërtohen edhe gypat për mbledhjen e ujrave atmosferik në

kanalizimin qendror atmosferik. Në fazën e dytë të punëve ndërtimore në pjesën e mesme të bulevardit do të vendoset zhardinierë betonike dhe hapësira do të gjelbërohet. Përgjatë trasës të Vidoe Smilevski Bato do të vendoset edhe ndriçim i ri me llamba të reja kursyese. Punët ndërtimore në bulevardin Video Smilevski Bato do t'i realizojnë ekipet e "Konstruktor".

Qyteti i Shkupit ndau mjete për përpilimin e projektit dhe për zgjidhjen ideore dhe i mbulon të gjitha shpenzimet për zgjerimin e bulevardit Vidoe Smilevski Bato. Për këtë projekt do të shpenzohen 30 milionë denarë.

ANKETË E QYTETARËVE NE UEB FAQEN E QYTETIT TË SHKUPIT

Shkupjanët kanë mundësi të tregojnë qëndrimin e tyre për nevojën e ndryshimeve në Ligjin aktual për Qytetin e Shkupit nëpërmjet anketës, e cila është vendosur në internet-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit, www.skopje.gov.mk.

Anketa është në suazat e inicia-

tivës së gjerë të Kryetarit të Qytetit të Shkupit Trifun Kostovski për ndryshime në Ligjin për Qytetin e Shkupit. Qytetarët mund të votojnë edhe duke telefonuar në linjën për qytetarë 3297-255 ose me shkrim me shkrim deri te Qyteti i Shkupit, bulevardi "Ilinden" p.n.

DRURË TË RINJ NË BULEVARDIN "MITROPOLIT TEODOSIJ GOLOGANOV"

Njëqind fidanë të rinj të llojit frashër do të mbillen përgjatë bulevardit "Mitropolit Teodosij Gologanov", nga "Alumina" deri te Shtëpia e studentëve "Goce Delçev". Bëhet fjalë për zbukurimin e gjelbërimit me fidanë të rinj në vendin ku janë prerë plepat e vjetër.

Meqenëse plepat ishin të vjetër, me rrënjë të sëmura, me trup dhe degë të thara, por edhe për shkak të sigurisë

dhe preventivës nga probleme shëndetësore, me kërkesën e qytetarëve, me urdhër të Qytetit të Shkupit, ekipet e NP "Parqe dhe gjelbërim" intervenuan para disa muajsh dhe prenë drurët e vjetër. Drurët e rinj, sipas karakteristikave të tyre, si drurë të lartë gjetherënës, nuk shkaktojnë alergji dhe nuk kanë aromë.

A.XH



MEMORANDUM PËR NDËRTIMIN E KORSISË PËR BIÇIKLETA

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Trifun Kostovski, ministri për ambient jetësor dhe planifikim hapsinor, Nexhati Jakupi dhe kryetari i Shoqatës së qytetarëve "Proaktiva", Vladimir Karçicki nënshkruan Memorandum mirëkuptimi për zbatimin e "Planit themelor për përdorimin e biçikletave në Shkup". Dokumenti posaçërisht ka të bëjë me rikonstrukcionin dhe sinjalizimin e korsisë për biçikleta në Komunën Aerodrom. Aktivitetet të cilat janë parashikuar me Memorandumin, janë përkrahur nga Ambasada e Holandës në vendin tonë.

Qëllimi i bashkëpunimit mes Qytetit të Shkupit, MAJPH dhe "Proaktiva" është promovimi i biçikletës si mjet udhëtimi i lirë dhe ekologjik për përdorim të përditshëm. Qyteti i Shkupit për realizimin e këtij projekti ndau 1.216.043 denarë nga të hollat e buxhetit dhe u zotua që në të ardhmen rregullisht t'i mirëmbajë korsitë për biçikleta që janë lëndë e këtij Memorandumi. Korsia për biçikleta në Aerodrom do të ndërtohet deri më 30 maj 2009.

- Më paraqet nder të veçantë që u mbledhëm sot sërisht së bashku që ta vërtetojmë përpjekjen tonë për ndërtimin dhe shënimin e korsisë për biçikleta, por gjithashtu edhe për ngritjen e ndërgjegjes së qytetarëve për mundësinë për shfrytëzimin e biçikletave jo vetëm si mjet rekreacioni por edhe si mjet alternativ transportues, me çka do të kontribuohet për zvogëlimin e gazrave të dëmshëm në ajër dhe në harxhimin më ekonomik të resurseve energjetike. Memorandumi për mirëkuptim që e nënshkruam sot paraqet vazhdimësi të aktiviteteve që u realizuan vitin e kaluar përmes projektit "Implementim i Planit themelor për përdorimin e biçikletave në Shkup", me realizimin e të cilit u ndërtua korsia për biçikleta nëpër territorin e qendrës së qytetit. Por, ne nuk ndalem këtu, por vazhdojmë me aktivitete, për çka jemi mbledhur edhe sot e kjo paraqet vërtetim për përpjekjen tonë të përbashkët në realizimin e pjesës së dytë të projektit e ky është rikonstrukcioni, konstruksioni dhe sinjalizimi i korsisë për biçikleta në Komunën Aerodrom - theksoi Trifun Kostovski pas nënshkrimit të Memorandumit.

E.K.

PO NDËRTOHET ZHARDINIER NË BULEVARDIN "KUZMAN JOSIFOVSKI – PITU"

Zhardinier i gjatë 920 metra i përgatitur prej elementeve parafabrikat beton i armuar do të zbkurojë pjesën e mesme të bulevardit "Kuzman Josifovski – Pitu". Ekipet e Qytetit të Shkupit filluan të ndërtojnë pjesën e betonit të zhardinierit, dhe pasi të përfundojnë pjesët ndërtimore, e njëjta do të mbushet me dhe, do të vendoset sistem ujitjeje "pikë për pikë" dhe do të mbillen fidanë të ndryshëm.

Në fazën përfundimtare është edhe furnizimi publik për zgjedhjen e realizuesit më të volitshëm që do të ndërtojë zhardinierët në bulevardet "Jane Sandanski", "8 Shtatori" dhe "Partizanski odredi". Zhardinieri në bulevardin "Jane Sandanski" do të jetë i gjatë 800 metra dhe do të shtrihet deri nga fillimi i bulevardit deri te kryqëzimi tek "Majčin Dom". Rrethimi i mesëm në bulevardin "Partizanski odredi", nga rruga "Ruzveltova" deri te ura "Kombet e Bashkuara", do të zëvendësohet me zhardinierë me gjatësi 2650 metra. Zhardinier do të ndërtohet edhe në bulevardin "8 Shtatori", nga fabrika "Alumina" deri në rrugën "Ilinden" dhe do të jetë 1100 metra i gjatë.

A.XH.

JU NDA PAJISJE E RE BRIGADËS PËR MBROJTJE KUNDËR ZJARRIT

Kryetari i qytetit Trifun Kostovski më 20 janar këtë vit brigadës për mbrojtje kundër zjarrit i ndau 300 copë pajisje mbrojtëse dimërore për zjarrfikësit e cila është në vlerë prej 1.840.000 denarë.

- Jeta e njerëzve të kërcënuar nga zjarret dhe e zjarrfikësve nuk kanë çmim dhe për këtë shkak Qyteti i Shkupit në vitet e kaluara raportin e vet me këta njerëz të guximshëm e shprehu me përmirësim permanent të kushteve për punë dhe të sigurisë të tyre personale - theksoi kryetari Kostovski.

Qyteti i Shkupit sivjet në buxhet ndau 25.880.000 denarë për furnizimin me automjete kundër zjarrit, automjete për teren, pajisje informatike, video dhe të komunikimit për brigadën kundër zjarreve në Shkup.

REKONSTRUIM I PARTERI NË HYRJE TË ÇARSHISË

Rekonstrukcioni i plotë i parterit hyrës në Çarshinë e vjetër të Shkupit, nga ana e Urës së gurit filloi vitin e kaluar. Me rekonstrukcion janë përfshirë shkallët, parteri dhe vet hyrja në Çarshi. Realizimi i projektit do të zhvillohet në faza, me qëllim që të mos pengohet lëvizja dhe siguria e kalimtarëve të shumtë.

- Ky është edhe një kontribut i Qytetit të Shkupit për revitalizimin dhe kthimin e bukurisë dhe atraktivitetit të Çarshisë, gjithashtu edhe të qytetarëve, të esnafëve dhe të turistëve nga jashtë në vendin i cili është njëri ndër monumentet më të rëndësishme kulturore të kryeqytetit

të Republikës së Maqedonisë – u shpreh Kryetari i Qytetit të Shkupit z.Trifun Kostovski i cili e vizitoi vendin e ndërtimit.

Në fazën e parë të realizimit të projektit për rekonstrukcion do të hiqen të gjitha pllakat nga parteri, e pastaj do të rrafshohet vendi dhe do të vendosen pllaka të reja. Punët duhet të mbarohen për 45 ditë pune, kurse do ti realizojë komuna e Çairit.

Qyteti i Shkupit siguron gjysmën shumës së përgjithshme të mjeteve të nevojshme për realizimin e projektit. Vlera e përgjithshme e këtij projekti arrin 8 milion denarë.



VIZITË TRADICIONALE NË SHTËPINË "NËNË TEREZA"

Me rastin e festës fetare "Vasilicë" dhe Viti i ri i Vjetër, Kryetari i Qytetit Trifun Kostovski dhe kryetarja e Këshillit të Qytetit të Shkupit, Irena Misheva e vizituan Shtëpinë për pleq "Nënë Tereza" në Zllokuqani. Shfrytëzuesit e shtëpisë nga Qyteti fituan fshesë me korent.

- Ndjeva nevojë të vi tek ju që t'ju them që nuk ju kemi haruar dhe se vazhdimisht punojmë për atë se si t'ju përmirësojmë kushtet në të cilat jetoni. Në vitin që është para nesh do të punojmë që të gjejmë zgjidhje për t'ju ndërtuar ndërtesë të re në të cilën do të vendoset Shtëpia "Nënë Tereza", në të cilën ditët do t'i kaloni me dëshirë dhe kënaqësi. Në buxhetin për sivjet parashikuam paragrafe të cilat do të na ndihmojnë të aplikojmë para vendeve të huaja në të cilat kujdesi për pleq është në nivel të lartë, që të na ndihmojnë në

ndërtimin e shtëpisë për pleq sipas standardeve evropiane - tha kryetari Kostovski.

Kryetari Kostovski gjatë vizitës në Shtëpinë "Nënë Tereza" interesoheshte se me çfarë aktivitete shfrytëzuesit e tij e kalojnë kohën e lirë dhe si organizohen për festa fetare. Kostovski propozoi që në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit të bëhet aukcion i punëve me dorë që cilat i përpunojnë gratë e Shtëpisë.

Udhëheqësit e Shtëpisë nga kryetari Kostovski kërkuan që Qyteti të ndihmojë në blerjen e një automjeti i cili do t'i plotësonte nevojat e përditshme të shfrytëzuesve. Ata morrën betimin nga kryetari Kostovski se para Këshillit të Qytetit të Shkupit në mënyrë urgjente do të propozojë që të blihet dhe të dhurohet një automobil për Shtëpinë "Nënë Tereza".

E.K.

Intervista me Dominik Tropeano, kryetar i Grupit për asistencë teknike në LEKZA.

KEMI MISION QË ZOO KOPSHTIN E SHKUPIT TA INKUADROJMË NË FAMILJEN EVROPIANE TË KOPSHTEVE ZOOLOGJIKE



Doktor Dominik Tropeano, është kryetar i Grupit për asistencë teknike dhe mirëqenie të kafshëve në Lidhjen Evropiane të kopshteve zoologjike dhe akuariumeve (LEKZA). Ai është një dashamirë i madh i kafshëve si dhe pronar i kopshtit më të madh zoologjik në Britani të Madhe, në pjesën lindore të Londrës. Tropeano është njëri prej themeluesve të LEKZA dhe në këtë organizatë punon në mënyrë aktive tani më njëzet vite. Me të biseduam gjatë vizitës njëjavore që pati qytetin e Shkupit dhe gjatë vizitës së kopshtit zoologjik..

Elena Kuzmanovska

Si është gjendja e kopshteve zoologjike në vendet tjera të Evropës Juglindore, të cilat sikur edhe Maqedonia, kalojnë në periudhën e tranzicionit?

-Shtetet e Evropës lindore, me vite të tëra ishin në një izolim politik, dhe kjo rezultoi deri te mungesa e vetëdijes publike në drejtim të organizimit dhe udhëheqjes me kopshtet zoologjike. Me rënien e perdes së hekurt, u vërejt se çmimi që kanë paguar kopshtet ekzistuese zoologjike gjatë këtyre viteve ka qenë një çmim tejet i lartë. Gjatë kësaj u bë e qartë se këto kopshte zoologjike duhet të modernizohen nëse pretendojnë që të punojnë edhe më tej, për arsye se në atë gjendje ishin të varfra dhe me pajisje të pa mjaftueshme. Menaxherët e këtyre kopshteve zoologjike treguan se ekziston vullnet që këto rezervate të arrijnë nivelin që e promovojnë kopshtet zoologjike në vendet e Evropës Perëndimore. Jam pozitivisht i befapsur prej talentit, efikasitetit, kreativitetit dhe përkushtimit të njerëzve që punojnë në kopshtet zoologjike në Evropën Lindore, me përpjekjet e tyre që të bëjnë diçka në të mirën e kopshteve në të cilat punojnë dhe për këtë konsideroj se objektivat e parashtruara janë të arritshme.

Si e vlerësoni përparimin e Kopshtit zoologjik në Shkup?

Atje kanë ndryshuar shumë gjëra gjatë katër viteve të fundit.

- Kopshtit zoologjik në Shkup i nevojitet një operacion ekstrem. Ky kopsht zoologjik ballafaqohet me shumë probleme dhe atij i nevojiten ndryshime të mëdha si dhe një vizion që të mbijetoj, përkundrazi ajo do të pushoj së vepruari. Në kopshtin zoologjik të Shkupit ekziston vullnet që të ndryshohen gjendjet dhe punët me të vërtetë kanë filluar të ndryshojnë. Kopshti u rrethua me mure të reja që është një gjë mjaft pozitive, në të po ndërtohen habitate të reja, mbillen bimë të reja dhe vizioni për përparim ngadalë po realizohet. E dini, kopshtet zoologjike janë për kafshët, por ato janë edhe për njerëzit, dhe kam kënaqësi të vi këtu dhe të shoh se njerëzit që e udhëheqin kopshtin zoologjik kanë vizion dhe vullnet për atë se çfarë duhet të ndryshohet. Konsideroj se kopshtit zoologjik i nevojitet një përkrahje më e madhe financiare nga vetëqeverisja lokale si dhe prej Qeverisë së shtetit tuaj.

Vallë e shikoni, për një të ardhme të afërt, Kopshtin zoologjik të qytetit të Shkupit pranë gjirit të kopshteve zoologjike dhe akuariumeve Evropiane?

- Detyra e Lidhjes Evropiane të kopshteve zoologjike dhe të akuariumeve është që kopshtin zoologjik të Shkupit ta vëzhgohet dhe t'i ofroj ndihmë teknike. Ne me të vërtetë nuk do të dëshironim që këtu të ndërtohet diçka që nuk do të funksiononte dhe që nuk do t'i plotësonte standardet bashkëkohore. Për këtë mendoj se janë të domosdoshme trajnimet permanente për të punësuarit dhe të udhëheqësit që do të udhëheqë me Kopshtin në periudhën e ardhme. Misioni ynë është që tani kopshtin zoologjik të Shkupit ta integrojmë në familjen Evropiane LEKZA që do të jetë pa dyshim një detyrë e vështirë për arsye se kopshti zoologjik në Shkup gjendet në një gjendje të pavoritshme dhe se do të duhet të rrezikojmë. Ne duhet të dimë se vallë ju keni përkrahje

të vërtetë prej pushtetit lokal dhe vallë jeni të vërtetë që mund të kryejnë këtë detyrë. Ne duhet të dimë se vallë këtu do të sigurohet një vazhdimësi e funksionimit dhe të avancimit. Nëse pas zgjedhjeve zëvendësohet udhëheqësia e kopshtit zoologjik, do të vinë njerëz të rinj me të cilët duhet sërisht të ndërtojmë bashkëpunimin dhe të përcaktojmë se vallë janë njerëzit e vërtetë që do të mund ta kryejnë këtë detyrë. Kjo mund të rezultojë me probleme dhe me ndërprerjen e bashkëpunimit.

Çfarë u ofron anëtarëve të saj anëtarësia në LEKZA?

- Anëtarësia në LEKZA hap shumë mundësi për bashkëpunim. Kopshtet zoologjike që janë anëtare në këtë organizatë profesionale paguajnë anëtarësi, kurse prej LEKZA fitojnë ndihmë teknike, këshilla dhe ekspertizë, si dhe mundësinë që marrin pjesë në projekte për konservim. Që një kopsht zoologjik të anëtarësohet në LEKZA ajo duhet të plotësoj disa standarde, por në rastin e kopshtit zoologjik në Shkup, ekziston një kategori e posaçme e anëtarësimit për një institucion i cili gjatë pesë viteve të ardhme ka për qëllim t'i arrij standardet e LEKZA. Udhëheqësia e Kopshtit zoologjik në Shkup aplikoi që të anëtarësohet në LEKZA për një periudhë derisa zgjat rikonstruksioni ose për anëtarësim gjatë pesë viteve të ardhme ne shpresojmë se do të mund të shohim përparim konkret. Deri atëherë ekspertët e LEKZA do të jenë të pranishëm në Shkup, do t'i vlerësojnë punët dhe do t'i kryejnë kontrollime para se të ndërmerren hapa më të mëdha.

Përparësi prej anëtarësisë në LEKZA është edhe mundësia që përmes lidhjes sonë të fitohen kafshë që përndryshe nuk mund të sigurohen. Te ne funksionon programi për kultivimin e kafshëve dhe nëse ndonjë kopsht zoologjik dëshiron të fitoj ndonjë kafshë, për këtë nuk do të paguaj dhe nuk do ta posedoj atë por kafsha edhe më tej është pronë e LEKZA. Kafshët, praktikisht i jepen hua ndonjë kopshti zoologjik, kurse ajo vetëm i mbulon shpenzimet e transportit.

Çfarë u diskutuar në punëtorinë që u mbajt në Shkup gjatë vikendit të kaluar, dhe që u organizua prej LEKZA ?

- Punëtorinë që u mbajt në Shkup gjatë vikendit të kaluar ishte në temën – Asistenca teknike dhe mirëqenia e kafshëve. Ne punojmë në projekte për përtëritje kopshtet zoologjike në 11 shtete mes të cilave përfshihen Rumania, Kroacia, Rusia, Turqia dhe shtete të tjera. Kopshti zoologjik në qytetin e Shkupit paraqet një pjesë të detyrës sonë. Në punëtorinë ishin të pranishëm dhjetëra ekspertë prej më shumë shteteve Evropiane dhe gjatë kësaj diskutuam për avancimet që i ka realizuar Kopshti zoologjik në Shkup.

PËR NJË UJËSJELLËS QYTETI TË PËRKRYER



Nga akuadukti i Mustafa-pashës, sot ekziston pjesa që përbën urë harqesh (ujësjellës mbitokësor) nëpërmjet të cilave bartet uji. Ai gjendet në daljen e Shkupit – Vizbegovë. Është ruajtur në një gjendje relativisht të mirë. Është ndërtuar që të kalojë luginën në këtë vend dhe të bart ujin nga njëra anë në tjetrën.

Tome Smilevski

Si të sillet uji në mënyrë më të sigurt deri në qytet që është në rritje? Si të kalohet lugina dhe të aktivizohen burimet e mëdha të Malit të Zi të Shkupit? Përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe sekretet ndërtimore të mjeshtërve të mëdhenj të këtyre hapësirave deri në ditët e sotme i fshih ujësjellësi i vjetër i Shkupit, i mëshiruar në Akuaduktin e Vizbegovës. Rinovimi i tij dhe promovimi para pubikut është ajo, që në të ardhmen duhet të bëjnë institucionet kompetente në vendin tonë.

Akuaduktet e kanë origjinën nga koha para Perandorisë romake, por kanë mbetur karakteristike e ndërtuesve romakë sepse ato e kanë

sjellë deri në përsosmëri ndërtimin e ujësjellësve. Për akuaduktin e Shkupit mendohej se daton nga koha romake ose bizantine, por hulumtimet e fundit treguan se ai është ndërtuar në periudhën kur Shkupi gjendej nën Perandorinë osmane, në shek. e 16-të kur janë ndërtuar amame dhe xhami për funksionimin e të cilave ishte e nevojshme sasi e madhe uji.

Në literaturë takohen hipoteza dhe fakte të ndryshme në lidhje me kohën kur është ndërtuar, por të dhënat për ndërtimin e ujësjellësit i gjejmë në Vakëfnamet e Mustafa-pashës, e cila daton nga 26.11.1514. Sipas këtyre të dhënave, Mustafa-pasha ndërtuesi i njërës prej xhamive më të bukura në Shkup, të ndërtuar në vitin 1492, ka ndërtuar edhe Akuaduktin.

Nga Akuadukti i Mustafa-pashës, sot ekziston pjesa e cila përbën urë harqesh (ujësjellës mbitokësor) nëpërmjet të cilave bartet uji. Ai gjendet në dalje të Shkupit – Vizbegovë. Është ruajtur në një gjendje relativisht të mirë. Është ndërtuar për të kaluar luginën në këtë vend dhe të bart ujin nga njëra anë në tjetrën.

Pikërisht, nëpërmjet tij uji është sjellë në Shkup nga burimet e pasura

të Malit të Zi të Shkupit. Ky objekt përbën një ndërtim monumental dhe është ujësjellës i tipit njëkatësh mbitokësor. Përbëhet prej 55 harqesh që mbështeten në kolona masive me bazë katrore. Të gjitha harqet kanë formë gjysmërrethore.

Gjatësia e konstruksionit të kësaj ure është 386 metra. Është ndërtuar me gurë dhe tulla, në të njëjtën mënyrë me të cilën janë ndërtuar edhe monumentet e tjera osmane tek ne. Me përdorimin e materialit ndërtimor me tonalitete të ndryshëm është arritur një pamje e shkëlqyer e objektit. Edhe pse ka një rëndësi të jashtëzakonshme kulturore-artistike, monumenti imponant për fat të keq nuk është afirmuar tek qytetarët dhe turistët. Lokacioni në të cilin gjendet është lënë pas dore.

Anonimiteti i Akuaduktit është rezultat i mosekzistimit të rrugës qasëse deri te ndërtimi dhe shenjave udhërrëfyese që do t'i orientonte vizitorët. Ndërtimi i bulevardit Sllovenia, i cili në një masë të madhe lehtësoi qasjen deri te Akuadukti ishte një nga përpjekjet e Qytetit të Shkupit për promovimin dhe afirmimin e monumentit kulturor-historik.

QYTETI I SHKUPIT PARTNER I ORGANIZATAVE CIVILE

Mirjana Apostolova

Shoqëria civile në suazat e qytetit të Shkupit përbën një bashkësi të madhe dhe të shumëllojshme. Një pjesë e madhe e organizatave civile që janë regjistruar në territorin e qytetit të Shkupit aktivitetin e tyre e bazojnë në nivel lokal, por nuk është i vogël numri i organizatave që veprojnë në nivel kombëtar. Pikërisht një potencial i tillë i sektorit civil, por edhe kompetencat e Qytetit në këtë pjesë, shtrojnë nevojën e përcaktimit të bashkëpunimit ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe organizatave civile.

Për këtë qëllim, në nëntor të vitit 2007 Këshilli i Qytetit të Shkupit miratoi Strategjinë për bashkëpunim me organizatat civile me Plan aksional për realizimin e saj, qëllimi i kryesor i së cilës është të mundësojë organizatat civile të përfshihen në mënyrë aktive në proceset e përcaktimit të politikave zhvilluese, aktiviteteve dhe iniciativave. Në përgatitjen e Strategjisë në mënyrë aktive morën pjesë mbi 120 shoqata civile, që veprojnë në territorin e Qytetit të Shkupit me rreth 300 pjesëmarrës.

Shoqatat civile identifikuan shumë qëllime nëpërmjet realizimit të të cilave duhet të vendosen mekanizma për bashkëpunim, të rritet qarkullimi i informatave, të rritet dhe të forcohet kapaciteti i administratës së qytetit, të zhvillohen partneritete strategjike, të realizohen aktivitete të përbashkëta në pjesën e mbrojtjes së ambientit jetësor dhe përmirësimit e pastërtisë së qytetit, të realizohen aktivitete nga fusha e shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe arsimit, të fuqizohen marrëdhëniet ndër etnike, të afirmohet barazia ndërmjet gjinive dhe të mundësohet rritja e shkallës së shfrytëzimit të teknologjive informatike.

Qyteti i Shkupit dhe organizatat civile si qëllim nr. 1, para vetes, kanë shtruar institucionalizimin e bashkëpunimit të ndërsjellë. Duke u nisur nga fakti se Qyteti i Shkupit ka një numër të madh fushash me interes për të, bashkëpunimi është përcaktuar të zhvillohet nëpërmjet formimit të trupave këshilldhënëse, të

ashtuquajtura grupe pune diskutimi dhe Forumit të OJQ-së të Qytetit të Shkupit.

GRUPE DISKUTIMI

Anëtarët e grupeve të diskutimit kanë mundësi të iniciojnë aktivitete dhe të marrin pjesë në pjesën participuese të krijimit të politikave për çështje të lidhura me kompetencat e Qytetit të Shkupit dhe drejtëpëdrejtë të propozojnë tema për debate, të cilat janë pjesë e Planit për punë të Forumit të OJQ-së të Qytetit të Shkupit.

Zgjedhja e anëtarëve në çdo trup tematik këshilldhënës, përkatësisht në grupet e punës tematike të diskutimit bëhet vetëm nga ana e organizatave civile, të dhënat e të cilave janë regjistruar në bazën e resurseve të Qytetit të Shkupit për të dhënat e organizatave civile. Numri i anëtarëve nuk është i kufizuar, por mund të plotësohet edhe me përfaqësues të tjerë të organizatave civile që punojnë me çështje të lidhura me kompetencat e Qytetit të Shkupit dhe tregojnë interes në grupet e diskutimit.


Tani për tani janë formuar 13 grupe diskutimi: kulturë, ambient jetësor dhe punë komunale, arsim, sport dhe

rekreim, zhvillim lokal dhe rajonal, urbanizëm dhe komunikacion, të rinj, psikologji, mbrojtje sociale dhe shëndetësore, përkrahje për persona me handicap, përdorimi i PAS, tregti me njerëz, të drejtat e njeriut dhe liritë dhe mundësi të njëjta ndërmjet meshkujve dhe femrave.

FORUMI I OJQ-ve TË QYTETIT TË SHKUPIT

Forum i qytetar është organ nëpërmjet të cilit organizatat civile kanë hapësirë të prezantojnë idetë dhe propozimet e tyre si dhe mundësitë për bashkëpunim të përbashkët dhe trupat e tij të punës. Misioni i Forumit është që të forcohet dhe të thellohet bashkëpunimi ndërmjet OJQ-ve dhe Qytetit të Shkupit dhe të gjendet metodë adekuate, efektive për tejkalimin e problemeve ose të nevojave që do të përcaktohen si akute në seancat e Forumit.

Zgjedhja e anëtarëve të forumit kryhet me votimin e anëtarëve të çdo grupi diskutimi. Anëtarë të Forumit janë Kryetari i Qytetit të Shkupit, përfaqësues të administratës së qytetit, anëtarë të Komisionit për marrëdhënie me komunat dhe bashkëpunim dhe



përkrahje të shoqatave civile dhe fondacioneve të Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe përfaqësuesit e grupeve të diskutimit. Gjithashtu, në punën e Forumit në varësi të pikës për punë, është lënë mundësia të ftohen edhe ekspertë sipas fushave të caktuara.

Në prill të vitit 2008 njëzëri janë miratuar dhe nënshkruar Deklarata për punën e Forumit, Kodeksi për sjellje profesionale dhe etike dhe Plani aksional për punën e Forumit për vitin 2008. Këto janë dokumente me të cilat përcaktohen rregullat e lojës në punën e Forumit dhe të anëtarëve të tij.

Kjo administratë nuk e vë në dyshim rëndësinë e sektorit joqeveritar, si një bashkim i vetëm civil në lidhje me çështje që janë me interes të përbashkët për bashkësinë dhe potencial për të ngritur iniciativa, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në jetën shoqërore të qytetarëve, dhe sidomos në nivel lokal. Qyteti i Shkupit me realizimin e këtij projekti do të kontribuojë që sektori joqeveritar, dhe sidomos shoqatat civile, që punojnë në mënyrë aktive në territorin e Qytetit të Shkupit, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe efikase të ndikojnë mbi punën dhe vendimet të cilat vetëqeverisja lokale duhet t'i sjellë me qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve – theksoi Kryetari i Qytetit të Shkupit, Trifun Kostovski në fillimin zyrtar të punës së Forumit të OJQ-së të Qytetit të Shkupit.

Ai theksoi se nëpërmjet përfshirjes aktive të shoqatave civile në punëtoritë tematike të parashikuara, Qyteti i Shkupit dhe ai, si Kryetar i Qytetit të Shkupit presin identifikimin preciz të shumë problemeve të tjera, dhe në të njëjtën kohë, pret shumë propozime konkrete për përmirësimin e jetës së qytetarëve në qytetin tonë.

Në suazat e aktiviteteve të Forumit gjatë vitit 2008 u organizuan tre tribuna tematike:

- "Shëndet emocional dhe mendor i popullatës së re – sfida dhe preventivë"

- "Kualiteti i arsimit në qytetin e Shkupit" dhe

- "Shkupi-Qytet i qëndrueshëm"

Konkluzionet dhe rekomandimet nga tribunat e mbajtura janë përfshirë në dokumentet planifikuese të Qytetit të Shkupit për vitin 2009.

Qytete të vëllazëruara – Saragosa

MISTIKË ANTIKE MES QENDRËS UNIVERSITARE



Është i njohur si qytet transit, por turistët që qëndrojnë në qytetin spanjoll Saragosa e zbulojnë zemrën e vërtetë të Spanjës, përzierje e mistikës antike, mjeshtërisë arkitektonike dhe trendeve moderne. Saragosa është qyteti i pestë me madhësi në Spanjë sipas numrit të banorëve (me shumë se 600.000 banorë) dhe është nikoqir i institucioneve politike dhe ekonomike të regjionit Aragonë. Saragosa është qytet i lirë dhe i hapur i vlefshëm për tu hulumtuar.

Kjo lagje evropiane moderne shtrihet në të dy brigjet e lumit Ibër. Me shumë se gjysma e popullsisë punon në veprimtari shërbyese, kurse prodhimi industrial është i vendosur në zonat industriale, në periferi të qytetit. Nëpër qendrën e Saragosës janë të shpërndara salla kinemaje, muze, teatro dhe qendra shoppingu. Muzetë e Saragosës janë shtëpi të veprave të njohura prej El Greko, Ribera, Goja, Rubens, Rembrant, Van Dajk, Velaskez dhe Renoar. Nga ana tjetër lagje të mëdha rezidenciale mbijnë larg qendrës së qytetit

I ashtuquajtur "Casco Viejo" është qendër historike e qytetit dhe e fsheh historinë e këtij qyteti spanjoll. Në historinë 2.000 vjeçare të Saragosës kontribut të saj kanë kulturat e Romakëve, të Krishterëve, të Arabëve,

të Evrejëve. Ndërtesat, pallatet dhe kishat reflektojnë stile të ndryshme dhe shkëmbim kulturash. Shumë monumete në Saragosë janë të vendosura rreth sheshit të madh Plaza del Pilar, për të cilin thuhet se është aq i madh sa të aterojnë dy aeroplanë. Këtu gjendet bazilika e madhe Basilica de Nuestra Senora del Pilar, katedralja La Seo dhe kulla mavare me zile në Iglesia de la Magdalena. Numri më i madh i objekteve të vjetra, pallateve dhe kishave në Saragosë datojnë mes shekujve 11 dhe 14.

Saragosa është qytet universitar me shumë se 500 vjet. Shkollat dhe fakultet më së shpeshti janë të themeluara në kampusin e sheshit San Francisco dhe në kampusin e ri teknologjik në territorin Aktur. Disa fakultete dhe institucione tjera universitare janë ende të vendosura në ndërtesat e vjetra të zbuluara në zemrën e qytetit.

Për ata që janë të interesuar për koridat dhe lufta me dema, koha e vërtetë për vizitë të Saragosës dhe të Spanjës është perioda prej shkurtit deri në tetor.

Saragosa është vëllazëruar me 13 qytete në gjithë botën, mes të cilave edhe me Shkupin.

E.K.

QYTETI I SHKUPIT

Kryetari i Qytetit të Shkupit
TRIFUN KOSTOVSKI
tel: 3 297 204
gradonacalnik@skopje.gov.mk
baraka nr: 4

Sekretari i Qytetit të Shkupit
LJUBISHA GEORGIEVSKI
tel: 3 297 281, 3 297215
baraka nr: 3

Kryetari i Këshillit të Qytetit të Shkupit
IRENA MISHEVA
tel: 3 297 207
irena.miseva@skopje.gov.mk
baraka nr. 1

Sektori për financa
Drejtues: Kërste Anadonovski
tel: 3 297 277
kandonovski@skopje.gov.mk
baraka nr: 7

Seksioni për përcaktimin dhe pagimin e tatimeve, taksave dhe kompensimeve tjera
tel: 3 297 280 - qarkullim dhe dhurata
tel: 3 297 316- pronë
tel: 3 297 314- taksa
danoci@skopje.gov.mk

•SEKTORI PËR MBROJTJEN E AMBI-
ENTIT JETËSOR DHE TË NATYRËS
Udhëheqës: Cvetanka Ikonovska -
Martinovska
tel: 3 297 301, baraka nr: 14
Cvetanka.Ikonovska@skopje.gov.
mk
infoekologija@skopje.gov.mk

•SEKTORI PËR PUNË KOMUNALE
Udhëheqës: v.d Jelena Perinska
tel: 3 297 392, baraka nr: 11
Jelena.Perinska@skopje.gov.mk

Inspektorati i Qytetit të Shkupit
Drejtues: Hamzi Xhaferi
tel: 3 297 359
hamzidz@skopje.gov.mk
baraka nr: 14

NDËRMARRJET PUBLIKE

NP "Parkingu i qytetit"
Drejtor: Ljupço Jovanov
jovanovlj@gradskiparkig.com.mk
tel: 3091 072 , 3091 074
www.gradskiparking.com.mk

Shërbimi i merimangës
tel: 3 238 871

NP "Rrugë dhe rrugica"
Drejtor: Ilija Martinovski
tel: 3 162 317

www.jpuliciipatista.com.mk
NQP "Shkup"
Drejtor: Alaksandar Boshkoviç
aboskovic@jsp.com.mk
tel: 3 174 265
www.jsp.com.mk

Qendra e dispeçerisë:
tel: 3 173 224

NP "Higjiena komunale"
Drejtor: Zlatko Dimovski
tel: 3 220 827
www.khigiena.com.mk

NP "Parqet dhe gjelbërimit"
Drejtor: Dushan Aviroviç
tel: 3 070 112

NP "Ujësjellësi dhe kanalizimi"
Drejtor: Igor Arnaudov
tel: 3 220 839
www.vodovod-skopje.com.mk

Rajonet për pagesë dhe mirëm-
bajtje të rrjetit të ujësjellësit dhe
kanalizimit

Rajoni 1 – Qendër
pagesa tel: 3 117 753
reoncentar@vodovod-skopje.com.
mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 3 238 992
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 3 137 123

Rajoni 2 – Kisella Voda
pagesa tel: 3 116 987
reonkiselavoda@vodovod-skopje.
com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 2 782 609
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 2 791 566

Rajoni 3 – Karposh
pagesa tel: 3 118 581
reonkarposh@vodovod-skopje.
com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 3 076 407
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 3 062 174

Rajoni 4 – Çair
pagesa tel: 3 117 673
reoncair@vodovod-skopje.com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 2 671 888
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 2 671 999

Rajoni 5 – Gazi Babë
pagesa tel: 3 116 889
reongazibaba@vodovod-skopje.
com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 3 174 524
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 3 174 524

INSTITUCIONET KULTURORE TË
QYTETIT

- Biblioteka „Vëllezërit Milladinov“
3162-544
- Qendra informative kulturore
3115-238
- Shtëpia e kulturës „Koço Racin“
3163-739
- Qendra kulturore rinore 3115508
- Muzeumi i qytetit të Shkupit
3115-367; 3113-609
- Salla Univerzale-Shkup 3245615
- Kopshti zoologjik 3220-578
- Qendra kulturore e fëmijëve
„KARPOSH“ 3116-159

NUMRAT MË TË RËNDËSISHËM

- Shërbimi i zjarrfikësve 193
- Qendra për menaxhimin me krizat
195
- Elektro-Shkup 02 3161454
- Ngrohtorja 02 3076200
- Qendra urgjente 02 3147147
- Spitali i qytetit 02 3130311
- Aeroporti „Aleksandar Makedon-
ski“ 02 3148333; 02 3148336
- Stacioni ndërkombëtarë i auto-
busëve 02 2466011; 02 2466313
- Stacioni hekurudhor 02 3164255
- Shërbimi amë - DQPM 3117 037;
3117 766
- Salla e kurorëzimeve 3118 250
- Inspektorati republikan i tregut
975
- SOS – gjendjet e krizës për fëmijët
dhe të rinjtë 0800 12 222; 3136 400
- SOS – për gratë dhe fëmijët vik-
tima të dhunës 9700
- SOS – informata dhe parandalimi
i tregtisë me njerës 0800 11 111;
3173 424
- Teatri dramatik 3063388
- Qendra teatrale e fëmijëve
3290111
- Opera dhe baleti maqedonas -
OBM 3114511
- Galeria kombëtare e Maqedonisë-
Stacioni i vogël 3126856

KOMUNAT E SHKUPIT

- Komuna Qendër 3203 680
- Komuna Kisella Voda 2785 400
- Komuna Aerodrom 2400 970
- Komuna Karposh 3061 507
- Komuna Gazi Babë 3226 655
- Komuna Çair 2616 865
- Komuna Butel 2616 868
- Komuna Shuto Orizare 2650 584
- Komuna Gjorçe Petrov 2039 307
- Komuna Saraj 2050 289



Matka

Bukuri shpellore